

JANAR 2025

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT TË MIRËKËPTIMIT MES MINISTRIË SË DREJTËSISË DHE UNDP LIDHUR ME RRIJTEN E NDIKIMIT TË SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË JETËN E QYTETARËVE

U firmos Memorandumi i Bashkëpunimit mes Ministrit të Drejtësisë, z. Besfort Lamallari dhe përfaqësueses së përhershme të UNDP në Shqipëri, znj. Randi Davis. Ky bashkëpunim synon të ripërtërijë partneritetin mes dy institucioneve në përmirësimin e kuadrit ligjor, investimin te profesionistët e fushës së drejtësisë dhe rrjetëzimin e shërbimofruesve, për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndikimin real të shërbimeve të ndihmës juridike falas te ata që kanë më shumë nevojë.



NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MES DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS DHE AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE




Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, u prit në takim nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, z. Klevis Hysa, ku shkëmbyen mendime mbi forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, mekanizmin e referimit të rasteve, si dhe ndërveprimin në nivel vendor për rritjen e efikasitetit të shërbimeve në funksion të qytetarëve. Takimi u finalizua me nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes dy institucioneve.

TAKIM ME PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT “LUARASI”

Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, zhvilloi një takim, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, me z. Admir Belishta, Dekan i Fakultetit të Drejtësisë në universitetin “Luarasi”.



INTERVISTË E DREJTORESHËS SË PËRGJITHSHME TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS PËR UNHCR



Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, zhvilloi një intervistë me përfaqësues të UNHCR në Shqipëri. Intervista kishte në fokus ndihmën juridike falas për refugjatët dhe azilkërkuesit.

TAKIME ME OFRUESIT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE



Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, zhvilloi takime në grup me të gjithë punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, për të diskutuar dhe koordinuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2026. Këto takime kishin si synim kryesor forcimin e bashkëpunimit, ndarjen e përvojave dhe planifikimin e aktiviteteve të cilat do të garantojnë më tepër akses të qytetarëve në shërbimet juridike falas.

TAKIM ME TË RINJ DHE TË MITUR NË KONFLIKT ME LIGJIN



Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me IEVP Kavajë dhe QSHNJP Durrës zhvilluan një sesion informues mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me të rinj dhe të mitur në konflikt me ligjin. Përfaqësuesit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas zhvilluan gjithashtu takime të veçara me të miturit të cilët shprehën interes në përfitimin e një avokati falas.

AKTIVITETE TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

QSHNJP Kukës në datën 30.01.2026 priti në një takim informues pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore nxënësit e shkollës “Havzi Nela”.



QSHNJP Gjirokastrë, më datë 14.01.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Brailit, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues me pjesëmarrjen e një qytetari që trajtohet me status verbër.


QSHNJP Gjirokastrë dhe Përmet në datën 26.01.2026 zhvilluan një aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të Ditës Botërore të Arsimit, pranë Zyrës Arsimore Gjirokastrë - Libohovë.



QSHNJP Gjirokastrë dhe Përmet në datën 26.01.2026 morën pjesë në një aktivitet pranë Kryqit të Kuq, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Kryqi i Kuq dhe përfaqësuesve të UNHCR.



QSHNJP Gjirokastrë në datën 26.01.2026 zhvilloi një intervistë për median lokale RTGJ me temë: “Ndihma juridike e garantuar nga shteti, rastet e trajtuara, shërbimet e ofruara për kategoritë përfituese”.



QSHNJP Tiranë, në datën 28.01.2026, organizoi një tryezë ndërinstytucionale me stafin e Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe zbatimit të Ligjit nr. 111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”.



QSHNJP Tiranë, në datën 27.01.2026, zhvilloi një aktivitet informues pranë gjimnazit “Sami Frashëri”, në kuadër të Ditës Botërore të Arsimit.

QSHNJP Dibër, me datë 28.01.2026, zhvilloi një aktivitet në Drejtorinë e Çështjeve Sociale, Bashkia Dibër.



QSHNJP Vlorë, me datë 15.01.2026, zhvilloi një aktivitet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Vlorë, me Drejtorin z. Nimet Dapaj, për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit praktik për qytetarët me statusin e invalidit.



QSHNJP Vlorë, me datë 23.01.2026, zhvilloi një aktivitet pranë Shkollës 9-vjeçare “4 Heronjtë” Vlorë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Arsimit dhe në zbatim të Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve miratuar nga DNJF.



QSHNJP Vlorë, me datë 29.01.2026, organizoi një takim me përfaqësues të UNDP pranë zyrës së saj. Takimi u zhvillua në formën e intervistës ndaj një qytetareje përfituese të shërbimit, si dhe ndaj punonjësve të QSHNJP Vlorë.



QSHNJP Vlorë, me datë 23.01.2026, zhvilloi një takim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me Gjyqtaren znj. Dorina Stroka, Kancelaren znj. Frida Gani dhe znj. Etleva Doraci, Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë.



QSHNJP Tropojë, me datë 23.01.2026, zhvilloi një aktivitet në shkollën 9-vjeçare "Konferenca e Bujanit", në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Arsimit. Qëllimi i aktivitetit ishte informimi i nxënësve mbi Ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", kategoritë përfituese dhe shërbimet që ofron qendra.



QSHNJP Lezhë, me datë 29.01.2026, realizoi afishimin e posterave në disa pika të rëndësishme në qytet. Posterat u vendosën pranë Shoqatës së të Verbërve, Dega Lezhë, pranë hyrjes së Shoqatës së Jetimëve, Dega Lezhë, si dhe në ambientet ku kryhet pagesa e ujit nga qytetarët pranë Ujësjiellës Kanalizime Sh.A.

QSHNJP Lezhë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Brailit, organizoi një takim me z. Zef Lleshi, Kryetar i Shoqatës së të Verbërve, Dega Lezhë.



QSHNJP Durrës në datën 23.01.2025, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Arsimit, zhvilloi një aktivitet të tipit "Street Law" pranë ambienteve të shkollës "Don Nikoll Kacorri", në zonën e ish-Kënetës, Durrës.

QSHNJP Shkodër, me datë 23.01.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Arsimit, zhvilloi një takim në ambientet e Bibliotekës Publike "Marin Barleti" me punonjësen z. Denisa Mesi.



QSHNJP Elbasan u ftua të merrte pjesë në mbledhjen e MKR-së Elbasan, e zhvilluar më datë 19.01.2026, me qëllim diskutimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për një rast dhune në familje.

QSHNJP Elbasan, me datë 26.01.2026, zhvilloi një aktivitet informues në formën e "Street Law", në kuadër të 24 Janarit - Ditës Ndërkombëtare të Arsimit. Qëllimi i aktivitetit ishte informimi i qytetarëve mbi Ligjin nr. 111/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti".



QSHNJP Korçë, me datë 21.01.2026, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, realizoi një takim informues me përfitues të aftësisë së kufizuar.

QSHNJP Korçë, me datë 22.01.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Arsimit, zhvilloi një takim informues me drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë, znj. Vinjola Rota.



QSHNJP Mat, me datë 14.01.2026, nënshkroi “Marrëveshje Bashkëpunimi për vijimin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të Dhunës në Familje (MKR) në Mat”.



QSHNJP Mat, me rastin e “24 Janarit - Ditës Ndërkombëtare të Arsimit”, zhvilloi një aktivitet në një nga shkollat 9-vjeçare të qytetit të Burrelit.

